



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1059/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Munib Durguti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1059/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Munib Durguti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 1626A/01R, 1601A/01R dhe vendvotimet në fshatin Xërxë dhe Fortesë në Rahovec.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Rahovecit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në vendvotimin 1626A/01R në Rahovec.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimin e vendosur si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Munib Durguti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në vendvotimin 1601A/01R dhe vendvotimet në fshatin Xërxë dhe Fortesë në Rahovec.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Munib Durguti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, në të cilën pretendon se në vendvotimin 1626A/01R në FRP-në e publikuar nga KQZ-ja vërehet qartë se është shënuar numri dyshifror 23 apo 29, ndërsa në rezultatet e publikuara po nga KQZ-ja i njëjti ka marrë vetëm 2 vota, kurse në vendvotimin 1601A/01R pretendon se komisionerët në bashkëveprim kanë paraqitur vota më pak në FRP sesa i njëjti ka në të vërtetë pasi që aty ka shumë familjarë që e kanë votuar të njëjtin.

Për vendvotimet në fshatin Xërxë dhe fshatin Fortesë pretendon se ka manipulime të votave pasi që janë zgjedhur dy kandidatë për asamble nga e njëjta familje ndërsa të njëjtit nuk kanë mundur të marrin aq shumë vota, pasi që në atë vendvotim i kanë votat kryesisht të rrethit familjarë dhe si të tilla nuk kanë mundur të vendosen për të dy kandidatët.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Munib Durguti nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet 1626A/01R, 1601A/01R dhe vendvotimet në fshatin Xërxë dhe Fortesë në Rahovec.

Paneli vlerësoi se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve vërehet se është shënuar numri 23 ndërsa të njëjtit në atë vendvotim në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja i janë publikuar vetëm 2 vota, andaj paneli duke marrë parasysh të cekurat më lartë konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me FRK-në e dorëzuar si provë, andaj PZAP në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1059/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.